



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 33 Datë 09.02.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“SEMAN SUNPOWER” SH.P.K, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK  
TOPOJË (SHEQ MARINAS) ME FUQI TË INSTALUAR 2000 KW.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 4, pika 1, gërma “a”; neni 5, pika 1 gërma “a”; neni 10, pika 1 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 19 pika 1 gërma “a” e “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 09.02.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për Licencimin e Shoqërisë “SEMAN SUNPOWER” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas) me fuqi të instaluar 2000 KW,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën me nr.109 Prot, datë 26.01.2018, shoqëria “SEMAN SUNPOWER” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas).
- Në datën 29.12.2017, është lidhur Kontrata me nr .6299 Rep. dhe 1598 Kol, “Për ndërtimin shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik “Topojë” me kapacitet të instaluar 2000 KW; në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të miratimit përfundimtar, shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me miratimin përfundimtar nr. 4115/3 Prot., datë 28.12.2017, ka miratuar ndërtimin e Centralit Fotovoltaik “Topojë” në favor të “Seman Sunpower” sh.p.k, me fuqi të instaluar 2000 KW, në koordinatat e përcaktuara në nenin 3 të Kontratës sipërcituar.

- Aplikimi i shoqërisë “SEMAN SUNPOWER” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, si më poshtë:
  - Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.4.1 4.4.2, 4.4.3 (gërmat “a”, “c”, “d”); 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2 gërma “d”, (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë);
- Nenin 9 pika 4.4.3 gërma “b” (dokumentacioni teknik dhe grafik);
- Nenin 9 pika 4.4.5 gërmat “a” (Miratimin e OST-s ose OSSH-s për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), do të njoftohet subjekti që ti plotësojë ato brenda afateve që përcakton “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SEMAN SUNPOWER” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai Topojë (Sheq Marinas) me fuqi të instaluar 2000 KW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**